

lexime ballkanike

p r o z a

seria: letërsi bashkëkohore nga Ballkani
konceptuar dhe përzgjedhur nga Arian Leka

Alek Popov | Misioni Londër

Titulli i origjinalit: АЛЕК ПОПОВ | МИСИЯ ЛОНДОН

copyright © Alek Popov, autor, 2007

Izdatelstvo "Zaharij Stojanov", 2007

copyright © i botimit shqip,

i shpërndarjes dhe i promovimit POETIKA dhe IDEART

ISBN 978-99956-29-99-1

redaktor: Silvana Leka

realizimi grafik: Genc Goga

Ky libër u botua me mbështetjen e Traduki, një rrjet që mbështet letërsinë, ardhur si nismë e përbashkët mes Ministrisë Austriake për Çështjet Europiane dhe Ndërkombëtare, Ministrisë së Jashtme Gjermane, Këshillit Zviceran të Arteve ProHelvetia, Kulturkontakt, Austria, Insitutit Goethe, Agjencisë Sllovene të Librit JAK si edhe Fondacionit S.Fischer, të cilët botuesi gjen rastin t'i falënderojë.

traduki

traduki

Shënim: Për përkthimin është përdorur botimi

Izdatelstvo "Zaharij Stojanov", 2007

MISIONI LONDËR

përktheu nga origjinali: Milena Selimi



botimet poeteka

botimet
ideart 

Kjo histori është krejtësisht pjellë e fantazisë. Çdo ngjashmëri me njerëz dhe ngjarje reale është rastësi.

Autori

即使我们的工作得到了极其伟大的成绩,也没有任何骄傲使人落后,我们应当永远记住这个真理.

Edhe sikur të arrijmë suksese gjigante në punën tonë, nuk ka asnjë arsye të jemi të vetëkënaqur dhe arrogantë. Thjeshtësia e ndihmon njeriun të ecë përpara, ndërsa kotësia e tërheq pas. Kjo është e vërteta, që duhet ta kemi parasysh gjithmonë.

Mao Ce Dun

(Përhëndetje drejtuar delegatëve në Konferencën e Tetë Kombëtare të Partisë Komuniste Kineze, 15 shtator 1956)

Kosta Baniçarov ishte ulur në oborrin e brendshëm të shtëpisë në Hajd Park Gejt dhe numëronte avionët që fluturonin mbi Saut Kensington. Ishte një mëngjes i butë pranvere me lagështirë të paqëndrueshme. Boshtra në qoshen e oborrit ishte në lulëzimin e saj të plotë. Kosta Baniçarov qëndronte zbatshur tek shkallët, me xhinse dhe kanotiere. Tek këmbët kishte një shishe "Beks", gjysmë të zbrazur, ndërsa mes gishtash i digjej cigarja e harruar. Avionët ngriheshin për afërsisht çdo dy minuta. Gjëmimi i motorëve mbetej gjatë, ndërsa shkrihej pandjeshëm me zhurmën e makinave të reja që afroheshin. Ai numëroi më shumë se njëzetë të tillë. Tingulli i kujtonte tallazet e detit. Dritaret e shtëpisë ishin të hapura. Rryma e erës sillte kutërbim bishtash cigaresh të vjetra. Perdet e lehta silleshin si vello e një aktoreje të dehur. Në dhomën e ngrënies së katit të parë dukeshin ende gjurmët e gostisë së mbrëmshme. Po afronte ora 11, por Kosta nuk nxitonte të pastronte. Kishte gjithë pasditen përpara.

Ndërkaq kishin kaluar edhe tri avionë të tjerë.

Zileja këmbëngulëse e nxori nga ai ekuilibër i ëmbël. Fillimisht, Kosta tha se, nuk kishte zot që ta detyronte ta hapte derën. Pastaj u zbut, duke pranuar se gjendje të tilla janë të gabuara dhe të dëmshme për biografinë e tij të punës. Ngjeshi bishtin e cigares në të çarën e pllakave dhe u ngrit qejfprishur. U çapit përmes foajesë. Pasqyra e stërmadhe prej kristali pasqyroi me dashakeqësi figurën e tij të dobët dhe shpejtoi ta nxirrte jashtë kornizave të praruara. Pasant zile të tjera, të shkurtra dhe të prera.

- Erdha, erdha! - mërmëriti Kosta dhe shtoi me vete: - Robt, ku t'i kesh!

Në prag qëndronte si hu me valixhe në dorë një burrë i gjatë, i ngrysur, me pardesy të gjelbër. Pas shpinës, një taksi e zezë londineze, kryente manovra të vështira për të dalë nga rrugica e ngushtë. Për disa sekonda, të dy studiuuan njëri - tjetrin me dyshim.

- Kë kërkoni? - pyeti Baniçarov në bullgarisht.

Fytyra e fishkur e zotërisë u gjallërua nga një buzëqeshje e thartuar.

- Unë jam ambasadori i ri, - tha dhe nguli sytë në këmbët e zbathura të tjetrit. - Po juve kush jeni?

- Po, unë, ja ashtu... - belbëzoi Kosta. - Unë jam kuzhinieri. "Ish kuzhinieri" (e përshkoi një parandjenjë e dhimbshme).

- Shumë mirë, - bëri me kokë ambasadori. - A mund të futem brenda?

Kosta u tërhoq në mënyrë mekanike, kur burri kaloi pranë tij ndjeu një të ftohtë të pakuptueshëm. Shpresa e vogël se kjo do të jetë një shaka e trashë, vepër e emigrantëve bullgarë, me të cilët kohët e fundit ishte afruar, filloi të avullojë. Burri la valixhen e tij në dysheme, shikoi përçark dhe ngriti vetullat me neveri. Kuzhinieri ndjeu se duhej të thoshte diçka, përpara se të hapte gojën tjetri.

- Ju prisnim pas dy ditësh, - tha me një qortim të lehtë.

- Duket, - ia hodhi me thumb ambasadori, duke parë nga dhoma e ngrënies.

- Po ta dinim, se do të vinit sot... - ia nisi kuzhinieri.

- I ndërrova planet, - e ndërpreu tjetri.

"Atëherë, mbaj inat me veten tënde, trap!", - mendoi Kosta Baniçarov.

Në gjithë ato vite, kaluar pranë tryezave të të mëdhenjve, kuzhinieri kishte fituar një nuhatje të veçantë psikologjike. Ai e nuhati menjëherë se shefi i tij i ri i përket familjes së gjerë dhe të pasur shumëdegëshe të idiotëve administrativë. Por, përtej shikimit të tij të ngrirë prej budallai kishte edhe diçka tjetër, që e bënte të paparashikueshëm dhe të rrezikshëm.

Kosta kuptoi menjëherë se tipi kishte ndërmend të vendosej këtu. Diçka më shumë, tani kjo ishte banesa e tij, ndërsa ai - Baniçarovi do të ishte shërbëtori i tij. Kjo iu duk tepër e padrejtë.

Djali i vogël i Baniçarovit erdhi zvarrë nëpër shkallët e katit përdhes, ku banonte familja e kuzhinierit. Ai i kishte shpëtuar vigjilencës së mamasë dhe ngazëllente. Duke mermëritur diçka në gjuhën e tij, fëmija u ngrit dhe me shpejtësi e me hapa të vegjël, u drejtua për nga tryeza e vogël nën pasqyrë. Mbi të ishte vendosur një send i brishtë, i cili ngacmonte prej kohësh instinktet e tij të lindura. Në rini Baniçarovi kishte trajnuar sporte të ndryshme, por me kohë kishte humbur zhdërvjelltësinë e tij të dikurshme. Fëmija u kap pas cepit të tryezës dhe e anoi. Shportëza e vogël prej porcelani, e regjistruar në numrin shtatëdhjetë e tre në librin e inventarit u rrëzua me një tingull apokaliptik mbi dysheme dhe u thye.

- Tëk - tëk! - belbëzoi vogëlushi i gëzuar.

- Ta tregoj unë ty "tëk - tëkun"! - skërmiti Kosta Baniçarov, duke mbytur vrullin e tij instinktiv për t'ia futur një lapër toçit.

Ambasadori e vështronte me një fytyrë pa shprehje.

- Punë fëmijësh, - mermëriti kuzhinieri jo dhe aq i bindur. E kapi fëmijën nën sjetull dhe u përkul mbi parmak.

- Norka! - thirri ai.

Përgjigje s'pati.

- Noorka! - përsëriti ai. - Eja menjëherë!

- Futja bythës tënde të qelbur! - u dëgjua një zë i ngjirur.

Kryetari i Bashkisë së Provadijas¹ i hapi me forcë rubinetet e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë dhe e la atë t'i rridhte bollshëm nga koka tek këmbët. Uji rridhte mbi fytyrën e tij të gjerë tartare, rrihte gjoksin e fuqishëm leshator dhe rrëshqiste lozonjar mbi barkun e tij titanik. Me gjithë hijen e lehtë të mahmurllekut të mëngjesit, e cila akoma e mbante të pushtuar turin, kryetari i Provadijas e ndjente veten për mrekulli. Ishte i përfshirë nga mendimi i misionit të kryer. Kishte vizituar këtë ishull të largët dhe enigmatik, i cili dikur kishte zotëruar gjysmën e botës. Kishte parë pallatet dhe dyqanet. Kishte njohur gjendjen e popullit. Kishte bërë përfundimet përkatëse dhe mund të thuhej me plot gojën se tashmë e kishte idenë për gjendjen e reformës në këtë vend të zhvilluar perëndimor. Ishte i kënaqur se nuk e kishte humbur mendjen pas shkëlqimit dhe kotësisë të Oksford Stritit. Por ishte i kënaqur edhe më shumë për faktin se atë ditë largohej për në Provadjen e vet - qyteti me një të kaluar të lavdishme dhe tokë pjellore.

- Olala! - thirri ai me zë të plotë. - La - la - laa - la!

Uji rridhte nga të gjitha anët si ujëvarë dhe krijonte tek kryetari ndjesinë e qetësisë dhe paqes shpirtërore. Pak nga pak llumi në kokën e tij hollohej dhe fitonte një qartësi të kristaltë.

- Lalaa - lala - lala - lalaa! - vazhdoi të këndojë ai duke sapunisur me ngulm flokët e tij të shkurtër.

Ai nuk vuri re dhe nuk mund të kishte vënë re vijën e

¹ Provadija - qytet në Bullgarinë Lindore, (shënimet në tekst janë të përkthyesit)

hollë të ujit që rrëshqiti nën derën e banjës dhe filloi të lëpijë ngadalë moketin.

Ambasadori mori valixhen dhe u drejtua nga kati i dytë pa thënë asnjë fjalë. Duke gjykuar nga fytyra e tij bërë jeshil, Kosta Baniçarov doli në përfundimin se magjia e dashurisë me shikim të parë nuk ndodhi. Perspektivat dukeshin edhe më të zymta.

Kishte arritur deri në mes të shkallëve, kur u ndal dhe vuri veshin.

- Atje është dikush, - tha ambasadori duke treguar me gisht lart.

- Ah, është zoti kryetar... - u përgjigj kuzhinieri, nga toni i tij mund të mendohej se bëhej fjalë për një kafshë shtëpiake, e cila banonte në rezidencë prej shumë kohësh.

Fëmija në duart e tij tërhiqej me një fuqi të paimagjinueshme, qante me të madhe dhe kafshonte. Ai e shtrëngoi dhe më fort dhe pëshpëriti nëpër dhëmbë:

- Mut muti, i ke ngjarë sat ëme!

- Kryetari?! - tha i shqetësuar ambasadori.

- Kryetari i qytetit të Provadijas, - saktësoi kuzhinieri me një farë ngushëllimi.

- Si gjendet këtu...ky njeri nga Provadija? - pyeti me neveri tjetri.

- E vendosën këtu, - tha Baniçarovi - s'kishte vende në hotel. Ikën sot.

Ambasadori nuk tha asgjë. Kishte përqendruar sytë tek rrugica, e cila në mënyrë kërcënuese e lagte sikur ndodhej në bordin e Titanikut. Mbi kokën e tij u dëgjuan hapa dhe sharje. Kryetari i Provadijas mbiu në sheshin e sipërm, i mbuluar me një peshqir të ngushtë nën të cilin ngriheshin përpjetë cilësitë e tij herculeske.

- Shiko, anglezë të trashë! - thirri ai. S'janë kujtuar të hapin një vrimë banje! Një vrimëzë e thjeshtë! Sa punë do! Një vrimë! Kanal.

Mblodhi gishtat në formë rrethi dhe pa nga vrima e formuar për të demonstruar dukjen e kësaj mungese të pavend. Në rrethin e shikimit, papritur, kapi zotërinë e ngrysur, i cili, me një shprehje të dhimbshme studionte vijën e ujit.

- Mirëdita, - tha kryetari dhe i hodhi një sy Baniçarovit. - Mik i ri, apo jo?

- Ky është ambasadori i ri, - tha kuzhinieri pa një entuziazëm të veçantë.

- Ahaaaa, kështu! - tha me zë të lartë kryetari i Provadijas. Urime!

U duk qartë se zotëria u tremb.

- Kam kënaqësinë të njihemi! - thirri burri lakuriq, me fytyrë tartare. - Do të më falni për pamjen. Ishte mirë që u pamë. Është për të ardhur keq, por unë sot nisem, ndryshe do t'u tregoja ca më shumë për këta hipokritë. Dua të mbani mend vetëm një gjë. Nuk ka demokraci në Angli. Kjo nuk është demokracia e vërtetë!

Fytyrën e ambasadorit e mbuloi hapur paniku.

- Nuk kam çfarë t'ju shpjegoj më shumë, - ia preu kryetari - do të bindeni vetë. Dhe mos harroni t'ua kujtoni për banjën. E kanë shtruar me mokat dhe kanë harruar kanalin! Që në takimin e parë zyrtar. Sa për nevojtozen! Bullgarët e vjetër e kanë shpikur nevojtozen e ujit, e dini? Edhe unë nuk e dija, por s'ka shumë kohë dhe tek unë erdhën disa arkeologë për të raportuar. E kishin zbuluar gjatë gjurmëve. Plot 600 vjet përpara evropianëve! Në qytetin e Provadijas!

I kënaqur nga efekti, që patën fjalët e tij mbi zotërinë e rëndësishëm, kryetari i Provadijas u përkul mbi parmakun dhe i thirri Baniçarovit: - O vëlla, a ka mbetur akoma nga ajo paçja e shijshme?

- Ka mbetur, - tha kuzhinieri. - Ta ngroh?

- A do të provoni pak paçe me një birrë të ftohtë? Është mirë për mëngjes, - iu drejtua me mirësjellje kryetari ambasadorit.

- S'e besoj, - tundi kokën thatë tjetri. Cepi i buzëve të tij u drodh me keqdashje. - Kam ndërmend të bëj një shëtitje. Mos më prisni për darkë. Pastroni këtë stallë derrash! - ishin fjalët e fundit drejtuar Baniçarovit.

Bëri një të kthyer me rrëmbim dhe nxitoi drejt daljes, duke lënë valixhen në shkallë. Por, para se të kalonte pragun qëndroi në sallon dhe thirri me një zë të hollë: 93!

- Çfarë ka ky djalë?... - mblodhi supet kryetari i Provadijas.

Varadin Dimitrovi e la rezidencën nën ndikimin e koktejit avullues, me ndjenja kontradiktore - zemërim, entuziazëm, përçmim, turp... dhe gjysmë i hutuar, ai kaloi largësinë prej dyqind hapash, që e ndanin nga rruga Haj Kensington dhe qëndroi i ngrirë para trafikut të makinave dhe autobusëve, që shkonte e vinte në dy drejtime. Përballë, bari i Kensington Garden sapo kishte gjelbëruar. Nëpër rrugicat, si të ishin qenie nga ndonjë utopi e largët, rrëshqisnin pa zhurmë njerëz me patina me rrota. Varadin Dimitrovi u drejtua nga semafori më i afërt. Një angleze e moshuar priste mbështetur mbi parmakun metalik. Pa ia hedhur sytë, ai fishkëlleu mes dhëmbësh:⁷⁴

Gruaja i hodhi një shikim të habitshëm dhe bëri sikur nuk e dëgjoi, duke ndjekur me saktësi rekomandimet e udhëzuesit të famshëm të xhepit *"How to sbun upsetting acquaintances"*². Në këtë çast, u hap drita jeshile. Lëvizja u ndal dhe Varadin Dimitrovi kaloi rrugën me hapa të gjerë, të ngadaltë, si një kompas. Gruaja e moshuar e ndoqi prej një largësie të arsyeshme.

Në park vraponin qen dhe fëmijë të vegjël. Dita ishte e thatë. Mbi bar kishte njerëz nga vende të ndryshme të botës, disa prej tyre tashmë gëlltisnin sandviçin e drekës. Varadin Dimitrovi u nis nga rrugica kryesore, pranë Kensington Palasit, shtëpia e së ndjerës Dajana Spenser. Nëpër gardh, vende - vende ishin vendosur buqeta me lule dhe kartolina me mesazhe, të lëna nga adhuruesit e pafundmë të princshës. Ai kaloi moskokëçarës pranë këtyre shenjave prekëse të dashurisë popullore dhe qëndroi për pak para monumentit të

² "Si t'u largohemi njohjeve të pakëndshme."

mbretëreshës Viktoria. Për çudi ajo i kujtoi një kushërirë të largët, prej së cilës, në rininë e tij, kishte ngrënë shumë dajak. Pastaj ktheu nga liqeni i Rrumbullakët dhe eci në bregun e shtruar me glasa zogjsh. Gjeti një stol të lirë dhe u ul. Një patë që kulloste aty afër zgjati qafën drejt këmbës së tij dhe gagariti me të madhe.

- 55! - tha ai.

Varadin Dimitrovi mbeti i ulur në stol përafërsisht gjysmë ore, pa mendime konkrete në kokë, me shikim të mbërthyer mbi sipërfaqen e sheshit të liqenit, ku notonin pupla të bardha. Rosat dhe patat e humbën nga pak interesin ndaj tij. Atëherë, krejtësisht papritur ai pëshpëriti:

- Një! Dhe buzëqeshi i lehtësuar.

"Terapia e shifrave" e doktor Pepolenit jepte vërtet rezultate të admirueshme. Si njeri i përballur vazhdimisht ndaj streseve njerëzore, Varadin Dimitrovi, mund ta vlerësonte këtë. Sistemi i Pepolenit bazohej në disa parime të thjeshta. Ai këmbëngulte se emocionet njerëzore (njësoj si tërmetet) mund të rreshtohen në shkallë nga 1 deri në 100, në varësi të intensitetit të tyre. Regjistrimi i emocioneve, - sipas Pepolenit - është një hap drejt zotërimit të tyre. Ai zhvillonte një *workshop* të posaçëm me individë pa stabilitet dhe lehtësisht të eksituar, duke i mësuar të matin shkallën e emocioneve të tyre. Puna qëndronte...: në momentin që ndjente humbjen e kontrollit mbi nervat e tij, pacienti duhej të thoshte me zë numrin e parë që i vjen ndërmend nga 1 deri në 100. Pas një intervali kohor ai duhej të thoshte një numër çfarëdo, me kusht që të ishte më i vogël se i mëparshmi. Radhës tjetër shifra vinte duke u zvogëluar. Dhe kështu me radhë, sa të arrihej deri tek numri "një". Në këtë moment, sipas doktorit Pepolenit, emocioni është plotësisht i zotëruar, i kopsitur dhe i neutralizuar, ndërsa individit i është kthyer ekuilibri i tij psikik.

Varadin Dimitrovi kishte pasur fatin ta takonte doktor Pepolenin gjatë mandatit të tij në një nga vendet nordike. Nën ngulmimin e të afërmeve të kujdesshëm ai u regjistrua në *workshop* - in e famshëm dhe gati prej tre vjetësh praktikonte

metodën e terapisë së shifrave. "Funksionon", ishte gjithçka që mund të thoshte. Prova për këtë ishte se tani, ai ndodhej këtu dhe nuk digjej, të themi, në zyrën konsullore të ambasadës në Lusaka. Në karrierë, nervat e shëndosha ishin njësoj si litari për alpinistin. Në qoftë se litari këputet, fluturon poshtë dhe mbetjet e tua do t'i mbledhin me fshesë. Kishte qenë dëshmitar i shumë rasteve të tilla. Nuk kishte ndërmend të bëhej një prej tyre. Kishte vetëm një rrugë - vetëm lart.

Tani, kur iku rrjedha e turbullt e emocioneve që e kishin pushtuar, në shpirtin e tij ndizej vetëm shkëndija e gëzimit të pastër, si një përrua mali. Kishte arritur qëllimin e tij. Çastin e befasisë. Turma e rëndomtë, e cila popullonte ambasadat nëpër botë, ishte hedhur në panik. Me një kënaqësi të jashtëzakonshme ai përfytyronte lëvizjen e ethshme në rezidencë. Telefonatat e ethshme. Panikun në ambasadë. Me siguri e prisnin të shfaqej nga çasti në çast. Takimet e lëna po shtyheshin. Tryezat e punës pastroheshin. Kishte ngatërruar planet e të gjithëve.

"Më lejoni të raportoj, - qeshi ai, - etapa e parë e operacionit "Mbërritja e shefit" përfundoi me sukses!